

Asambleja e Akademisë së Shkencave

për të rejat dhe epërsitë e ligjit të ri

Për shtypin dhe gjithë të interesuarit

Tiranë më, 19 korrik 2019

Asambleja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, duke vlerësuar përmbylljen e suksesshme të procesit të hartimit dhe miratimit të ligjit të ri mbi të cilin do të mbështetet veprimtaria e saj institucionale, e ndien të nevojshme të përgëzojë dhe falënderojë gjithë subjektet që bashkëpunuan dhe dhanë ndihmesat e tyre për këtë proces të vështirë, por të suksesshëm, që do të hapë një perspektivë të re për historinë e akademizmit në Shqipëri.

Falënderimet tona janë për grupin e punës të kryesuar nga akademiku Skënder Gjinushi që përgatiti projektin bazë për vetëreformimin e Akademisë së Shkencave; deputetët e nderuar me në krye znj. Eglantina Gjermani që morën përsipër ushtrimin e së drejtës së nismës juridike dhe organizuan këshillime, plotësime e saktësime të projekti; oponentët e rrjetit europian të Akademive ALLEA, që jo vetëm ndihmuan seriozisht për eurokodifikimin e ligjit, por edhe e mbështetën atë publikisht dhe me një solidaritet shembullor; Akademinë Gjermane “Leopoldina”, që mund të konsiderohet bashkëhartuese e projektit; të nderuarit deputetë të komisionit të medias dhe informimit, që shqyrtuan me përgjegjësi projektligjin në tërësi dhe në çdo formulim; me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, që u bashkua me shqetësimin tonë dhe ofroi ndihmë cilësore në takimin me ligjvënësit shqiptarë dhe me kolegë e specialistë; për institucionet e arsimit të lartë dhe institutet kërkimore shkencore që, me konsultimet, përkrahjen apo kontestimet e tyre ndihmuan për të konkluduar në një variant më të përpiktë të ligjit; Këshillin e Ministrave, që u shpreh me akt zyrtar me sugjerime dhe mbështetje për projektin e kthyer tashmë në ligj; Kuvendin e Shqipërisë dhe administratën e tij, që mirëkuptuan shqetësimin tonë dhe hapën rrugë për fillimin dhe përfundimin e procedurave në një kohë paragjykimesh të njohura që dominonin opinionet publike.

Asambleja e Akademisë së Shkencave vlerëson se progresi që sjell ligji i ri i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën e datës 18 korrik 2009 qëndron në sa vijon:

1. Ky ligj bën të detyrueshme vendosjen e kriterëve dhe procedurave të qarta për pranimet e reja; bazuar mbi kontribute të certifikuara dhe në përcaktimin

e tyre; përmes tij për herë të parë përfshihen edhe strukturat e përfaqësuesit e institucioneve të kërkimit shkencor e studimit në vend, si IAL, institutet kërkimore.

2. Rikthen legjitimitetin e anëtarësisë, të diskriminuar vetëm për arsye moshe, duke zhbërë praktikant antikushtetuese që cenojnë hapur lirinë akademike dhe autonominë e Akademisë së Shkencave;

3. Krijon mundësinë e rifreskimit të Asamblesë me përfaqësues të shquar prej gjeneratave të reja, në harmoni me të mëparshmet, nëpërmjet futjes së statusit të anëtarit “Emeritus”.

4. Mundëson anëtarësim si anëtarë të jashtëm e korrespondentë të kërkuesve të suksesshëm shqiptarë jashtë vendit, duke zgjeruar kështu bashkëpunimin dhe radhët e Akademisë, me përvojat më të mira.

5. T’u garantojë që zgjedhjet e anëtarëve të Asamblesë të zhvillohen në përputhje me parimin e barazisë gjinore, duke synuar progresivisht balancën gjinore të përfaqësimit.

6. Krijon mundësi ligjore për një kohezion e bashkëpunim të institucionalizuar më intensiv dhe më të suksesshëm me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës e akademi të tjera në rajon, çka mundëson optimizimin e kërkim studimeve veçmas në fushën e albanologjisë dhe të burimeve natyrore.

7. Ligjëron krijimin e Akademisë së të Rinjve, çka mundëson mbi të gjitha rritjen e rolit të Akademisë për të nxitur e mbështetur formimin dhe promovimin e kërkuesve të rinj.

8. Siguron me ligj, jo thjesht si një vullnet, një bashkëpunim e pjesëmarrje të përfaqësuesve të IAL e instituteve kërkimore në aktivitetin e misionin e Akademisë së Shkencave, nëpërmjet përfaqësimit të tyre në komisione, në instancat e përzgjedhjes së kandidaturave dhe në mbledhjet vjetore të ASH.

9. Mundëson krijimin e njësisë të kërkim-studimit, çka rrit përgjegjësinë dhe mundësinë e Akademisë së Shkencave dhe akademikëve në dhënien e mendimeve, opinionëve e opionëve të studiuara, në rritjen e rolit aktiv të saj për kërkimin shkencor në vend dhe zgjerimit të tij nëpërmjet përfitimit të projekteve.

10. Përcaktohet ligjërisht nevoja dhe mënyra e bashkëpunimit të Akademisë së Shkencave me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin.

11. Me ligjin e ri u rikthehen të drejtat anëtarëve të privuar prej tyre për shkak të moshës; krijohen hapësirat për 10-15 pranime të reja si anëtarë me të drejtë vote nga kërkuesit e krijuesit më të spikatur në vend; hapet rruga

për mbi 15 pranime për herë të parë prej kërkuesve më të suksesshëm jashtë vendit, si anëtarë të jashtëm apo anëtarë korrespondentë si dhe për pjesëmarrje aktive të 30-40 akademikëve shqiptarë në rajon; përfshihen në bashkëpunim të rregulluar me ligj mbi 30 përfaqësues të IAL dhe institucioneve kërkimore në komisione; fitojnë status ligjor të rregullt 20 anëtarë të *Akademisë së të Rinjve*. Rrethi i akademikëve të vendit arrin në mbi 50 anëtarë aktivë dhe rreth 90 bashkëpunëtorë, çka e kthen realisht Akademinë e Shkencave në një qendër të debatit shkencor në vend.

12. Asambleja vlerëson se një nga sukseset e reformës ishte që ndali antireformën. Vetëreformimi sipas ligjit të ri pengoi tendencën për rikthimin tek praktika e rithemelimit me dispozita antikushtetuese (të konstatuara si të tilla nga Gjykata Kushtetuese me vendim), praktikë e paprecedent në Europë dhe që mundësonte ndërhyrjen e Qeverisë në zgjedhjen e përzgjedhjen e anëtarit të Asamblesë që çonte në shpërbërje të Akademisë për motivet bashkëmbyllur.

Reforma ligjore e mbylli këtë kapitull negativ dhe përmes aprovimit të ligjit të ri hap një perspektivë zhvillimi pozitive për vetë Akademinë dhe shkencën shqiptare në përgjithësi.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Shtojcë

Në vijim të pikës 11:

E vetmja klauzolë e kundërshtuar parimisht, me vendim konsultativ të Asamblesë, nga gjithë çka është propozuar pranë këtij institucioni, drejtpërdrejt a mediatikisht, ishte propozimi që për anëtarët mbi 68 vjeç të hiqej e drejta e votës dhe që “reforma” të kryhej nga 7 prej akademikëve të mbetur (nga 10-15 gjithsej). Kjo pasi në gjithçka tjetër s’kishte asnjë vizion të ri, sepse ishte kopje e keqe e antireformës së vitit 2007, me të cilën iu hoq e drejta e votës anëtarëve mbi 75 vjeç. Kjo praktikë antikushtetuese, shkelte hapur liritë akademike; ndante akademikët në proreformë e antireformë, vetëm për arsye moshe; ishte një praktikë e provuar tashmë vetëm në Shqipëri e s’ka rezultuar e suksesshme; s’përbënte hapje të Akademisë ndaj institucioneve të tjera, por ajo mbyllej edhe ndaj vetes; ishte ligjërisht e pazbatueshme pasi Asambleja pas kësaj nuk ekzistonte më (s’kishte shumicë), pra s’bënte dot as *pranime* as *miratonte* statut të ri. Kjo klauzolë shpërbënte e jo më të rithemelonte Akademinë e Shkencave, ishte një model i dështuar unikal shqiptar që i “kundërvihet” një reforme të sistemit europian të certifikuar nga ALLEA.